



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja c dhe nenit 40, paragrafi 40.2, shkronja a e Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/04 qershor 2008), të nenit 15, shkronja f të Ligjit nr. 03/L-049, për financat e pushtetit lokal (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 27/03, qershor 2008), nenit 32 të Ligjit nr. 03/L-025, për mbrojtjen e mjedisit (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 50/06, prill 2009), të nenit 15 të Udhëzimit administrativ nr. 1//2017, për dhënien e lejes mjedisore komunale, dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja c e Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 06.08.2018, e miratoi këtë

**RREGULLORE
PËR
CAKTIMIN E VLERËS REFERENTE INVESTUESE TË PROJEKTIT TË
NDËRTESAVE PËR CAKTIMIN E TARIFËS PËR LEJE MJEDISORE KOMUNALE
NË KOMUNËN E PRISHTINËS**

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është krijimi i të hyrave vetanake buxhetore të Komunës, caktimi i vlerës referente investuese të projektit të ndërtesave, me qëllim të standardizimit të caktimit të tarifës sipas Udhëzimit administrativ nr. 01/2017, për dhënien e lejes mjedisore komunale.

**Neni 2
Fushëveprimi**

Në bazë të kësaj rregulloreje përcaktohet vlera referente investuese e projektit, për objektet që kanë për qëllim parandalimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis, për caktimin e tarifës për leje mjedisore komunale në komunën e Prishtinës.

Neni 3

Organi kompetent

Organi kompetent për përcaktimin e tarifës për leje mjedisore sipas projektit, është Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, gjegjësisht Sektori për mjedis dhe eficientë.

Neni 4

Kriteret e llogaritjes së tarifës

Kriteret e llogaritjes së tarifës janë marrë nga vlerat mesatare në vend dhe rajon, vlerat mesatare të projekteve në paramasa të paraqitura në Drejtorinë e Urbanizmit dhe vlerën mesatare të projekteve të paraqitura në Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave.

Neni 5

Baza dhe mënyra e llogaritjes së tarifave

Bazë dhe mënyrë e llogaritjes së tarifave është përqindja e përcaktuar sipas Udhëzimit administrativ nr. 01/2017, për dhënien e lejes mjedisore komunale dhe vlerës referente investuese të ndërtimit të paraqitur në raport sipas kësaj rregulloreje.

Neni 6

Llojet e objekteve

6.1. Objektet prodhuese industriale do të llogariten me vlerën investuese në shumë prej 395 € për m², si vijon:

6.1.1. Sharrë për lëndë drunore;

6.1.2. Fabrikë për përpunim druri, mobilieri, tapiceri deri 1000 m³/vit;

6.1.3. Prodhimi i betonit dhe elementeve tjera parafabrikate, pllakave etj. me kapacitet të projektuar deri në 2 m³ beton/orë;

6.1.4. Rritje artificiale e peshkut në hudhra, me sipërfaqe deri në 300 mx;

6.1.5. Veprimtaria e prodhimit të kompostit, me sasi totale përpunimi deri në 100 m³ ose 40 tonë/vit;

6.1.6. Prodhimi i dyerve dhe dritareve të plastikës.

6.2. Ndërtimi i objekteve të banimit kolektiv dhe të shërbimeve (tregtare, komerciale, afariste etj.) me sipërfaqe bazë mbi 450 m² ose në sipërfaqe totale të objektit mbi 1500 m² dhe impiantët për rritjen intensive të shpezëve, bagëtive të imëta dhe të mëdha, që kanë më pak se: 500 shpendë, 250 derra, 50 gjedhe, 500 bagëti të imëta, do të llogariten me vlerën investuese në shumë prej 300 € për m².

6.3. Ndërtimi i objekteve hoteliere do të llogaritet me vlerën investuese në shumë prej 557 € për m².

6.4. Ndërtesat afarsite do të llogariten me vlerën investuese në shumë prej 478 € për m², si vijon:

6.4.1. Stacionet e karburanteve me kapacitet deri 50 m³ ;

- 6.4.2. Lokalet afariste;
 - 6.4.3. Autoserviset;
 - 6.4.4. Autoserviset me automjete jashtë përdorimit deri 20 copë;
 - 6.4.5. Pishinat, pa objekte hotelerie dhe objekteve përcjellëse;
 - 6.4.6. Depot për plehra kimike dhe pesticide;
 - 6.4.7. Vendet apo qendrat për mbledhje dhe grumbullim të mbeturinave, ku magazinohen mbeturinat inerte (plastikë, letër dhe qelq), në sasi deri 30 t.
 - 6.4.8. Vendet e tregimit të kafshëve në vende të hapura dhe të mbyllura;
 - 6.4.9. Pikat e magazinimit dhe tregimit të materialeve të ndërtimit;
- 6.5. Infrastruktura rrugore, do të llogariten me vlerën mesatare investuese si vijon:
- 6.5.1. Ndërtimi dhe rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit të ujërave të zeza, në gjatësi deri 5 km, 150.000.00 € (30.000.00 për 1 km);
 - 6.5.2. Ndërtimi dhe rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit, në gjatësi deri 5 km, 150.000.00 € (30.000.00 për 1 km)
 - 6.5.3. Riparimi i rrugëve urbane ekzistuese dhe ndërtimi i akseve të reja rrugore (me gjatësi deri në 5 km), 1,750.000.00 € (350€ për m²).
- 6.6. Veprimtaritë afariste do të llogariten me vlerën investuese në shumë prej 150 € për m², si vijon:
- 6.6.1. Furra për prodhim të bukës dhe produkte të tjera nga mielli;
 - 6.6.2. Prodhimi i gëlqeres së shuar;
 - 6.6.3. Punishtet për përpunim të mermerit;
 - 6.6.4. Stacionet e karburanteve të gazit (GLN) deri 5 m³;
 - 6.6.5. Autolarjet;
 - 6.6.6. Mishtoret;
 - 6.6.7. Objektet shërbyese për ushqime (qebaptore, ëmbëltore, gjellëtore, restorante etj.);
 - 6.6.8. Qendrat zejtare;
 - 6.6.9. Serviset (servisimi i pajisjeve teknike dhe elektronike);
 - 6.6.10. Studiot fotografike;
 - 6.6.11. Pajisjet për shfrytëzimin e fuqisë së erës për prodhimin e energjisë, me fuqi instaluese deri në 100 Kw/orë.
 - 6.6.12. Sistemet solare me sistemet fotovoltaike të prodhimit të energjisë/avullit, deri 100 Kw/orë.
 - 6.6.13. Stacionet e telefonisë mobile.

Neni 7
Afatet e pagesës

Pagesa bëhet në afat prej 5 (pesë) ditësh nga dita e marrjes së aktvendimit për taksë, të lëshuar nga organi kompetent.

Neni 8
Lirim nga tarifat

Të gjithë poseduesit e lejeve të lëshuara për ndërtimet me karakter të interesit publik, të ndërtuara nga investimet kapitale të Komunës dhe nivelit qendror, të ndërtimeve për nevojat e zgjidhjes së çështjes së banimit të rasteve sociale me investime në bazë të donacioneve, familjeve të ngushta të dëshmorëve, invalidët e luftës, veteranët e luftës, ish - të burgosurit politikë dhe familjet e ngushta të tyre, personat me aftësi të kufizuara, objektet për përfaqësuesit diplomatikë, ku investuese janë shtetet e huaja, investimet publiko-private dhe objektet me destinim fetar.

Neni 9
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-020/01-194106/18, më 08.08.2018

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

